



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-070/01-24427/23 datë:01.09.2023



Npi – 01/319 datë: 06.09.2023

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2, shkronja (d), nenin 44, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenet 31, 32 dhe 33, të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Rregullorës (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës; Nenin 6 të U.A. të (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të mbajtur më, 06.09.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHKARKIMIN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -I- të Jashtëzakonshme për vitin 2023, të mbajtur më: 06.09.2023, me 11, vota “Për” me 0, vota “Kundër” dhe me 0, vota “Abstenim” miratoi Vendimin për shkarkimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes z.Adnan Ademi.

II

A r s y e t i m: Procesverbali dhe transkripti i mbledhjes për miratimin e këtij vendimi, përmbajnë arsyet për shkarkim sipas pikës I të këtij vendimi.

III


Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi Npi – 01/269 datë:08.12.2021, për zgjedhjen e z.Adnan Ademi, në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Mbledhjes
Hasan Avdyli